

KRITERET PËR PJESËMARRJE, KUALIFIKIM DHE VLERËSIM TË OFERTËS

Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e shitjes nga marreveshja e drejteperdrejte çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

- Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Biznesit
- Çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in
- Në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit do të depozitohet pranë komisionit të ofertave publike

Autoriteti shitës, kur kërkohet informacion për ofertuesin resident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

Skualifikimi i ofertuesve

- Autoriteti shitës skualifikon në çdo kohë kandidatët ose ofertuesit, që paraqesin të dhëna të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi, gjatë një procedure më shitje ngamarreveshja e drejteperdrejte. Autoriteti shitës në këtë rast vendos përjashtimin nga shitja të ofertuesit që ka përdorur këto të dhëna apo dokumente.
- Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Për të vërtetuar se Kandidatët Blerës janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

Të gjithë dokumentat origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

